



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja s) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjin për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafi 1.19 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Rregullores nr.prot.01/172-400 për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferte të datës 27 shtator 2012, në implementim të Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes Komunës së Podujevës dhe KRM "Pastrimi" sh.a. (nr.prot.-KRM "Pastrimi" 2901 datë 23.09.2020 dhe nr.prot.-Komuna 02-352/01-005838237/20 datë 25.09.2020), sipas Konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa nr.prot.01-016/01-0014172/22 të datës 25 shkurt 2022, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022, miratoi këtë;

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE – KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A

Neni 1

Me këtë vendim i ndahen mjete financiare në shumë 20,000.00€ Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave - KRM "Pastrimi" Sh.A.

Neni 2

Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria e subvencioneve, programi buxhetor 18165, dhe ka për qëllim përmbushjen e një pjese të obligimeve financiare të Komunës sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit të lidhur mes Komunës së Podujevës dhe KRM "Pastrimi", në funksion të realizimit të projektit për ndërtimin objektit për nevojat e Ndërmarrjes së cekur.

Neni 3

Shuma e mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi, bartet nga Komuna në xhironlogarinë bankare të KRM "Pastrimit"

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 5

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot.01-01-400/03-0014595/22
Podujevë,
28 shkurt 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha